



Nr. Ref. BD-203/59

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr.06/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 65, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr.20; Monting Energetika Lokali në Prishtinë me ofertues me çmim 121,250 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 65.

Bazuar në Nenin 14.3.1 të Rregullave të Tenderit, pasi që çmimi i pranuar është më i ultë se çmimi orientues, është refuzuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.


Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/60

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 65, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr. 22 "MF Lokali nr.4 në Podgoricë" me ofertues me çmim 111,111 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 65.

Bazuar në Rregullat e Tenderit është refuzuar shitja e këtij aseti pasi që nuk kemi pas mundësi të krahasojmë çmimin e ofruar me ndonjë çmim tjetër krahasues

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.


Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 maj 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/61

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 65, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr. 23: IMF Lokali nr.15 në Podgoricë me blerës me çmim 85,555 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 65.

Bazuar në Rregullat e Tenderit është refuzuar shitja e këtij aseti pasi që nuk kemi pas mundësi të krahasojmë çmimin e ofruar me ndonjë çmim tjetër krahasues

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.


Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Bestin Fasim



Nr. Ref. BD-203/62

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr. 6/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 65, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet shitja e Njesisë nr. 26 “NSH “Zhupa Reçane” - Shitorja nr.7 në Llokvicë” me blerës me çmim 5,000 €.
- II. Drejtori Ekzekutiv udhëzohet të nënshkruajë marrëveshjen për shitblerje të aseteve dhe dokumentet tjera përcjellëse. Drejtori dhe menaxhmenti i AKP-së gjithashtu do të ndërmarrin të gjitha veprimet e domosdoshme me qëllim që të përfundojnë transferimin e asetit dhe për përfundim të transaksionit të shitjes.
- III. Dokumentet e tilla të referuara në paragrafin (II) më lartë do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre nga palët e domosdoshme, pa nevojë për ratifikim pasues nga ana e Bordit, kërkesë prej së cilës këtu hiqet dorë sa i përket këtyre transaksioneve specifike të privatizimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 65.

Bazuar në Nenin 14.2.1 të Rregullave të Tenderit pasi që është tenderimi i shtatëmbëdhjetë (17) i këtij aseti, rekomandohet aprovimi i shitjes.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë. Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/63

Në bazë të neneve Neni 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për shitjen e aseteve në likuidim dhe Procedurave të shitjes për shitjen e aseteve në likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes procedurës me shkrim sipas nenit 10.6 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datë 23 maj 2024 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet lista e aseteve për shitje në SHAL 66 me gjithsej 55 asete dhe me gjithë depozitat e propozuara.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të listës së aseteve për Shitje të Aseteve përmes Likuidimit SHAL 66. Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, AKP ka zotësi të plotë juridike, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

Në këtë kontekst një ndër detyrat themelore të Agjencisë është procesi i shitjes së pronave shoqërore në mbarë territorin e Kosovës dhe jashtë sajë. Ndër format e shitjeve që i përdorë Agjencia Kosovare e Privatizimit është shitja përmes tenderit publik dhe atë kryesisht nëpërmes grupimit të aseteve në Shitje të Aseteve përmes Likuidimit (SHAL).


Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024





Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

1 / 1

Nr	Projekti	APD O	Emri i Komitetit	IF nr.	Emri / Adresi	Kategoria e aritjes	Marrëveshja e aritjes	Shënim	Komuna	Udhëzimi i aritjes	Spesifikimi i shtesë	Depozita e Vlerësimit	Adrestit që bën pjesë në krah të aritjes së përfunduar	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Vlerësimi
47	Prishtinë	PRN019	BANKA025	F120189	Banaka Postepule	Lokali	Objekt i forte		Prishtinë	Lokali në objektin banor	85.9	€ 10,000	1	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Tërhequr nga SHALIS me kontratë të Komunes, tërhequr nga SHALIS me vendim të BDI të
48	Prishtinë	PRN026	BOSBA	N/A	Borba Lokali Adresit Prishtinë	Lokali	Objekt i forte		Prishtinë	Lokali afër në krah të Dardanis	125.75	€ 15,000	1	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	PA DIFERTA SHAL 24, PA DIFERTA SHAL 56, Pa oferta nga SHAL 62, Pa oferta nga SHAL 63, Pa oferta nga SHAL 64
49	Prishtinë	PRN031	Separaçioni qendror Gjakovë	F1-416/87	Asitet e kundërthymë Gjakovë	Zyrë	Objekt i forte		Gjakovë	Lokali afër në krah të Dardanis	209.92	€ 15,000	1	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	SHAL 58 referencuar nga Bendi, Referencuar nga Bendi, SHAL 61, Pa oferta nga SHAL 62, Pa oferta nga SHAL 64, Pa oferta nga SHAL 65
50	Prishtinë	PRN033	USZTA	F123/88	Ushtra Lokali nr.23 në Dardanis	Lokali	Objekt i forte		Prishtinë	Referencuar nga Bendi me sipërfaqe prej 134 m ² , Asitet gjendet në një sipërfaqe të asitetit të "Dardanis" zona e asitetit dhe prej 40 m ² , Prishtinë	24.65	€ 10,000		Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	SHAL 58 referencuar nga Bendi, Referencuar nga Bendi, SHAL 61, Pa oferta nga SHAL 62, Pa oferta nga SHAL 64, Pa oferta nga SHAL 65
51	Prishtinë	PRN075	IF PROLETIER	N/A	IF Proletier Lokali në Dardanis	Lokali	Objekt i forte		Prishtinë	Referencuar nga Bendi me sipërfaqe prej 134 m ² , Asitet gjendet në një sipërfaqe të asitetit të "Dardanis" zona e asitetit dhe prej 40 m ² , Prishtinë	114	€ 25,000	1	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Referencuar nga BDI SHAL 63, Pa oferta nga SHAL 64, Pa oferta nga SHAL 65
52	Prishtinë	PRN079	Udhëja e Kooperativave të Kuvendit	F1-48/77	Ndërtues Administrativë e Udhës së Kooperativave të Kuvendit	Ndërtues administrativë	Lokali dhe lokale		Prishtinë	Ndërtues BIP 1.1 dhe lokale në qendër të Prishtinës	370	€ 70,000		Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Duhen marrë parasysh SHAL 64
53	Prishtinë	PRN098	USZTA	N/A	USZTA Lokali në Prishtinë	Lokali	Lokali		Prishtinë	Lokali me sipërfaqe prej 213 m ² , Udhëzimi i aritjes së përfunduar referencuar nga Bendi me sipërfaqe të asitetit të "Dardanis" zona e asitetit dhe prej 40 m ² , Prishtinë	113	€ 15,000		Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Ka qerë përfaqësuar nga SHAL 56, më pas është tërhequr për SHAL 61 të Komunes së Prishtinës, si asitet me interes publik. Krah të asitetit referencuar nga Bendi me sipërfaqe prej 213 m ² , Prishtinë
54	Prishtinë	PRN029	Referencuar nga Bendi	F1-24/88	Referencuar nga Bendi	Lokali	Lokali		Prishtinë	Referencuar nga Bendi me sipërfaqe prej 213 m ² , Udhëzimi i aritjes së përfunduar referencuar nga Bendi me sipërfaqe të asitetit të "Dardanis" zona e asitetit dhe prej 40 m ² , Prishtinë	113	€ 3,000		Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Referencuar nga BDI SHAL 63, Referencuar nga BDI SHAL 64, Referencuar nga BDI SHAL 65
55	Prishtinë	PRN034	MONSTRATIZETAKA	F132/91	Monstratizetaka Lokali në Prishtinë	Lokali	Lokali		Prishtinë	Referencuar nga Bendi me sipërfaqe prej 213 m ² , Udhëzimi i aritjes së përfunduar referencuar nga Bendi me sipërfaqe të asitetit të "Dardanis" zona e asitetit dhe prej 40 m ² , Prishtinë	174	€ 15,000	1	Aspektet që duhen marrë parasysh gjatë aritjes së përfunduar	Referencuar nga BDI SHAL 63, Referencuar nga BDI SHAL 64, Referencuar nga BDI SHAL 65

MA



Nr. Ref. BD-203/64

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës parashtruese e kërkesës: sipas aurorizimit, përfaqësuese e - Bartës i të drejtës banesore me numër KB-1792/24e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh Fapol, Pödujevë (PRN023)
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: parashtruese e kërkesës: sipas aurorizimit, përfaqësuese e - Bartës i të drejtës banesore për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh Fapol. Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/65

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palës parashtruese e kërkesës: me numër KB- KB-1796/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Radio Televizioni i Prishtinës", Prishtinë (PRN150).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtrues i kërkesës: parashtrues i kërkesës: për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Radio Televizioni i Prishtinës", Prishtinë (PRN150). Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hysni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/66

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesit dhe te përfaqësuar nga av. , ku bartës i të drejtës banesore është me numër KB-1793/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e blerjen e podrumit të adaptuar të ndarë në shfrytëzim nga NSh Elan Prizren (PRZ015)
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesit e kërkesës: dhe te përfaqësuar nga av. . Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palëve janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjijtje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon: Vendim mbi ndarjen e banesës dhe Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6 . lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hysoni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/67

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekzistojnë drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekzistojnë drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesja: _____ ku bartës i të drejtës banesore është _____ (tani i ndjerë) me numër KB-1685/22 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e blerjen e podrumit të adaptuar të ndarë në shfrytëzim nga NSh. KOSOVODRVO – KOMERC OBPB “MEBLE” – Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesja e kërkesës: _____ ku bartës i të drejtës banesore është _____ (tani i ndjerë). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekzistojnë drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si “Ligji për Shitjen e Banesave”) lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon: Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI) si dhe sipas Përgjigjes nga AKKVP me nr.ref.00066/23/hj e datës 24.01.2023 për pronën e cila gjendet në Prishtinë Dardania SU-9/1, Lamela 4, banesa nr.47. Komisioni pas shqyrtimit të shkresave të kërkesës me vendimin HPCC/D/116/2004/A vendosë që kërkesa DS003488 të refuzohet. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/68

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesja ku bartës i të drejtës banesore: me numër KB-1786/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e blerjen e podrumit të adaptuar të ndarë në shfrytëzim nga NSh BVI Banesave-Prizren (PRZ055).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit refuzohet si e bazuar në kërkesa e palës parashtruesja e kërkesës: ku bartës i të drejtës banesore:

Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si “Ligji për Shitjen e Banesave”) lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuar në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon: Vendimin mbi ndarjen e banesës dhe Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).


Nga te lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/69

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesi me numër KB-1444/17 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e blerjen e podrumit të adaptuar të ndarë në shfrytëzim nga NSH Kualiteti Gjilan (GJI015).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesi i kërkesës Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon: Vendim mbi ndarjen e banesës dhe Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).


Nga te lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/70

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruar nga parashtruesit e kërkesës , ku bartëse e të drejtës banesore: me numër KB-1749/23 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e blerjen e podrumit të adaptuar të ndarë në shfrytëzim nga NSh Boksitët e Kosovës, Klinë (PEJ093)
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës parashtruesit e kërkesës ku bartëse e të drejtës banesore . Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si “Ligji për Shitjen e Banesave”) lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se nuk posedon: Kontratë mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6 , lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).


Nga te lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Second Cash-Book

1850

1851

1852

1853

1854

1855

1856

1857

1858

1859

1860

1861

1862

1863

1864

1865

1866

1867

1868

1869

1870

1871

1872

1873

1874

1875

1876

1877

1878

1879

1880

1881

1882

1883

1884

1885

1886

1887

1888

1889

1890

1891

1892

1893

1894

1895

1850

1851

1852

1853

1854

1855

1856

1857

1858

1859

1860

1861

1862

1863

1864

1865

1866

1867

1868

1869

1870

1871

1872

1873

1874

1875

1876

1877

1878

1879

1880

1881

1882

1883

1884

1885

1886

1887

1888

1889

1890

1891

1892

1893

1894

1895



Nr. Ref. BD-203/71

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia sipallet jokompetente për kërkesën me numër KB-1798/24 e parashtruar nga i autorizuar nga _____, ku bartësi i së drejtës banesore është Isaitović e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 13.05.2024 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Ndërmarrja: Banka Popullore e Kosovës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 13.05.2024 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës _____ i autorizuar nga _____ ku bartësi i së drejtës banesore është _____ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Ndërmarrja: Elektrokosmet. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik Ndërmarrja: Elektrokosmet nuk është NSH dhe nuk bie nën jurisdikcionin administrativë të Agjencisë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/72

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 13.05.2024 lidhur me asetet e Ndërmarrjes OPB "UNIPROM" OTHPB "Joshanica" Novi Pazar, asetet në Prishtinë/Kosovë, sipas të cilat asetet në Prishtinë/Kosovë, janë në pronësi shoqërore dhe të njëjtat bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe dëshmime të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se OPB "UNIPROM" OTHPB "Joshanica" Novi Pazar, asetet në Prishtinë/Kosovë janë në pronësi shoqërore, andaj rrjedhimisht konform nenit 5 të ligjit të lartcekur të Agjencisë, bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.


Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/73

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 13.05 2024 lidhur me asetet e Ndërmarrjes OPB “Zhitomlin” Kombinati i Ushqimit OTHPB “Trgovina” Svetozarevo, sipas të cilit të gjitha asetet e kësaj ndërmarrje që janë apo do të identifikohen në të ardhmen nga AKP në territorin e Kosovës, janë në pronësi shoqërore dhe të njëjtat bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe dëshmi të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se Ndërmarrjes OPB “Zhitomlin” Kombinati i Ushqimit OTHPB “Trgovina” Svetozarevo, sipas të cilit të gjitha asetet e kësaj ndërmarrje që janë apo do të identifikohen në të ardhmen nga AKP në territorin e Kosovës, janë në pronësi shoqërore andaj rrjedhimisht konform nenit 5 të ligjit të lartcekur të Agjencisë, bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.


Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/74

Në bazë të neneve 2.1, 6.2, 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 18.1.3 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa e KK Kamenicë për rrënimin e objektit administrativ (ku ishte e vendosur Kuvendi Komunal i Kamenicës) të NSH Agroprodukti, i ndërtuar në ngastrën kadastrale 01981-0 ZK Kamenicë dhe objektin e ashtuquajtur të "Antikës" i cili shërbente si mensë e ish-punëtorëve të NSH Agroproduktit i ndërtuar në ngastrën kadastrale 01984-0 ZK Kamenicë dhe depon nr. 1 e ndërtuar në ngastrën kadastrale 01984-0, ashtu që i jipet leja KK Kamenicë për rrënimin e vetëm depon nr. 1 të ndërtuar në ngastrën kadastrale 01984-0 ZK Kamenicë për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqet ky objekt. Kërkohet dhe në të njëjtën kohë i lejohet KK Kamenicë që të bëjë rrënimin e këtij objekti dhe pas rrënit të bëjë pastrimin e gjithë hapësirës.
- II. Për objektin administrativ të NSH Agroproduktit i ndërtuar në ngastrën kadastrale 01981-0 dhe për objektin "Antika" i ndërtuar në ngastrën kadastrale 01984-0 kërkohet të përgatitet një raport i vlerësimit nga ana e një eksperti/vlerësuesi të pavarur për të nxjerrur përfundimet nëse duhet lejuar rrënimin e këtyre dy objekteve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit me anë të cilit u trajtua kërkesa e nga Kryetari i Komunës së Kamenicës për rrënimin e objektit të Agroproduktit (ish-Komuna) i ndërtuar në ngastrën kadastrale 01981-0 ZK Kamenicë dhe objektit të "Antikës" me objekte të tjera si depo nr.1, depo nr.2 dhe depo nr.3 të ndërtuar në ngastrën kadastrale 01984-0 ZK Kamenicë në pronësi të NSH Agroprodukti, GJI028.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se: Kërkesa e KK Kamenicë me nr. protokollin 763 e pranuar më datë 04.03.2024 përmes të cilit kërkohet nga AKP që të largojë objektet në fjalë ose të ja rikthejë Komunës për arsye se të njëjtat paraqesin rrezik për jetët e qytetarëve. Me shkresën e pranuar si konstatim i gjendjes fizike të objekteve me nr. reference Sh.Z. nr. 06-10565/24 është pranuar nga AKP me datë 29.04.2024 me nr. protokollin 14243/IN në të cilën është përshkruar çështja si në vijim: "Duke u bazuar në raportin e Komisionit të Komunës së Kamenicës, i cili ka bërë inspektimin e objekteve të vjetërsuara, kanë konstatuar që këto objekte janë jashtë funksionit dhe të dëmshme për rrethinën ku gjinden dhe se këto objekte duhet të largohen nga parcelat ku gjinden". Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren, mund të vërehet që gjendja e objekteve është jo aq e mirë, mirëpo aktualisht këto objekte nuk paraqesin rrezik të shemben dhe poashtu nuk mund të konstatohet gjendja që në këto objekte ka mbeturina të shumta.

Objekti "Antika" apo mensa e ish-punëtorëve të NSH Agroprodukti deri vonë në bazë të raporteve periodike në terren ka qenë duke u shfrytëzuar nga një familje me asistencë sociale e cila ishte vendosur aty nga ana e KK Kamenicë dhe si rrjedhojë mund të nënkuptohet që ishte i shfrytëzueshëm dhe aktualisht nuk ka sasi të mëdha të mbeturinave, përpos mbeturinave/inventarit të vjetër.



Objekti administrativ i NSh "Agroprodukti" ka qenë i pashfrytëzuar që nga viti 1993. Pas vitit 2000, për një kohë të shkurtër ka qenë i lëshuar me qira Komunës së Kamenicës deri sa kanë ndërtuar objektin e ri të administratës. Gjendja e objektit është mjaft e mirë, nuk ka mbeturina, dhe është i mbyllur.

Objekti i ish-hambarit apo depo nr.1 siç paraqitet në kërkesën e KK Kamenicë është objekti më i dëmtuar dhe i ndërtuar kryesisht vetëm nga druri dhe është objekti i vetëm që sipas Autoritetit të Likuidimit, në bazë të gjendjes faktike në terren plotëson kushtet për të i dhënë leje KK Kamenicë për të bërë rrënimin.

Autoriteti i Likuidimit konsideron që raporti i Komisionit të KK Kamenicë në këtë rast përmes të cilit kërkohet rrënimi i objekteve të NSh Agroprodukti, nuk është mjaftueshëm i argumentuar me arsyet të cilat do të arsyetonin rrënimin e këtyre objekteve. Kryesisht, arsye kryesore merret që në këto objekte ndodhen mbeturina që paraqesin rrezik për banorët dhe se në hapësirat përreth është investuar në ndërtimin e sheshit dhe poashtu ka edhe investime private dhe kështu këto objekte e prishin pamjen e vendit. Nuk mendojmë që është arsye e mjaftueshme për rrënim të objekteve vetëm për arsye se në këto objekte ndodhen mbeturina, për arsye se mbeturinat mund të largohen nga çdo hapësirë që ndodhen dhe është pikërisht përgjegjësi e ndërmarrjeve të pastrimit të çdo Komune që të bëjnë pastrimin e këtyre hapësirave dhe poashtu edhe inspektorëve përgjegjës që të mos lejojnë hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë të destinuara për mbeturina. Përfundimisht, nga kjo pjesë bënë vetëm objekti i ish-hambarit apo depo nr. 1 që sipas Autoritetit të Likuidimit është objekti i dëmtuar në pjesën më të madhe dhe i ndërtuar nga druri dhe si i tillë plotëson kushtet për tu rrënuar. Poashtu, rrënimi nuk mund të arsyetohet me faktin që e prishin pamjen e vendit, për arsye se në rast se këto objekte vlerësohen si potenciale për privatizim atëherë pas investimeve adekuate do të mund të adaptoheshin dhe merrnin pamje të objekteve moderne. Lejimi i rrënimin, pa pranuar edhe ndonjë raport të ndonjë vlerësuesi të jashtëm të pavarur, Autoritetit të Likuidimit nuk i jep siguri juridike që është duke vepruar drejtë dhe në mënyrë të arsyeshme dhe do ta ekspozonte Autoritetin e Likuidimit për ndonjë padi të mundshme nga ana e Kreditorëve (ish-punëtorëve të NSh-së), duke qenë se obligim i Autoritetit të Likuidimit është mbrojtja e interesave të kreditorëve.

Agjencia nuk mund të konstatojë që raporti i Komisionit të KK Kamenicë është i drejtë dhe i arsyeshëm, andaj u konsiderua i nevojshëm angazhimi i një eksperti/vlerësuesi të jashtëm i cili do të përgatiste një raport duke konstatuar gjendjen e objekteve dhe për të sqaruar nëse të njëjtat do të mund të ishin objekt i privatizimit dhe të përcaktojë vlerën aktuale të tyre dhe poashtu të përcaktojë shkallën e rrezikshmërisë dhe të përcaktojë se a rrezikohen këto objekte nga shembja dhe në varësi të rezultateve të raportit të ekspertit/vlerësuesit të jashtëm të nxirret edhe vendimi.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Menfor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/75

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 08/L-2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Neneve 252 – 260 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet kërkesa e KRU Gjakova SH.A. për vendosjen e gypit nëntokësorë përmes parcelave me numër 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelën 156-0 ZK Trakaniq, pronë e NSH Ereniku - Prodhimtaria Primare e cila do të shërbejë shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshme për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan.
- II. Obligohet parashtruesi i kërkesës që vendosjen e gypit nëntokësorë ta bëjë në atë mënyrë që të ngarkojë sa më pak që është e mundur parcelat me numër 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelën 156-0 ZK Trakaniq dhe pas vendosjes së gypit nëntokësorë të bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit me anë të cilit u trajtua kërkesa e për lejimin e vendosjes së gypave të ujit përmes parcelave 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq komuna e Gjakovës pronë e NSH Ereniku - Prodhimtaria Primare

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se: KRU Gjakova SH.A. ka paraqitur kërkesë me datë 29.03.2024 me numër të protokollit 110/2024 IN, përmes së cilës kërkon që të i lejohet që përmes parcelave 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq, komuna e Gjakovës, pronë e KBI Ereniku – Prodhimtaria Primare, të vendos gypin nëntokësor i ujit.

Vendosja e këtij gypi do të bëhet sipas standardeve dhe parametrave të përcaktuara nga ana e KRU Gjakova SH.A. Parcelat numër 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcela numër 156-0 ZK Trakaniq janë prona të KBI Ereniku – Prodhimtaria Primare, Parcela 62-0 ZK Jahoc dhe parcela numër 156-0 ZK Trakaniq nuk janë të dhënë me qira kurse parcela 46-0 ZK Jahoc është e dhënë me qira.

Sipas vlerësimit të AL-së, vendosja e këtij gypi nëntokësorë përmes parcelave 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq nuk dëmton parcelat në pronë e NSH Ereniku Prodhimtaria Primare, pasi që kërkuuesi pasi përfundon procesin, do ta kthejë parcelën në gjendjen e mëparshme. Pas përfundimit të vendosjes së gypit, parcelat do të kthejë në gjendjen e mëparshme. Në rast që nuk bëhet kthimi në gjendje të më parshme, atëherë Autoriteti i Likuidimit do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të realizojë kompensimin e dëmit dhe kthimin në gjendje të mëparshme të parcelave 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq. Kthimi në gjendjen e mëparshme në këtë rast nënkupton pas vendosjes së gypave, mbulimin e hapësirave të cilat janë hapur me qëllimin e vendosjes së atyre gypave.

Në bazë të gjendjes faktike si dhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pala, vendosja e gypit përmes parcelave nr. 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq, pronë e NSH Ereniku - Prodhimtaria



Primare, arsyetohet edhe për faktin se parcelat nr. 62-0, 46-0 ZK Jahoc dhe parcelës 156-0 ZK Trakaniq janë dhe pothuajse e vetmja zgjidhje që të bëhet shtrirja e këtij gypi i cili do të siguronte ujë të pijshme për fshatrat Lugbunar, Osek Hile dhe Skivjan. Për më tepër, vendosja e këtyre gypave është në interes publik për faktin që disa fshatra dhe familje do të furnizohen me ujë të pijshëm.


Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/76

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 5.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në, Neni 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet korigjim të sipërfaqes dhe çmimit vlerësues për njësinë nr. 91 Toka Bujqësore në ZK Vitomiricë KBI "Bujqësia" PEJ055 dhe ndryshimi i Vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-200/21 të datës 29.03.2024 në raport vetëm me njësinë nr. 91:
- 715-2 me sipërfaqe prej 13555m²;
 - 715-3 me sipërfaqe prej 2040m²;
 - 716-2 me sipërfaqe prej 7543m²;
 - 718-0 me sipërfaqe prej 2067m² ;
 - 1206-1 (pjesërisht) me sipërfaqe prej 19138m² .
 - 1206-3 me sipërfaqe prej 21476m² dhe
 - 1207-2 me sipërfaqe prej 1185m²

Me sipërfaqe të përgjithshme prej 6ha 70ari 04m² ose 67004 m² duke përfshirë edhe sipërfaqen e parcelës 715-3 me sipërfaqe prej 2040m², dhe çmimi pas përfshirjes së sipërfaqe së parcelës 715-3 të jete prej 1,373.58 €/ari/vit.

- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit me anë të cilit u trajtua kërkesa për Aprovimin të Korigjimit të Çmimit vlerësues për njësinë nr.91, në shpalljen qiradhënien e asetëve të datës 28 shkurt 2024 NSH KBI Bujqësia në Vitomiricë, PEJ055 (në likuidim)

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se: Pronat e lartpërmendura të cilat ishin pjesë e qiradhënies së asetëve janë paraqitura në bazë të Certifikatës së Pronësisë së asetëve të NSH KBI Bujqësia. Për këto prona nuk kemi pasur ndonjë kërkesë për qiramarrje dhe të njëjtat janë vendos në bazë të verifikimit të asetëve për qiradhënie të tokave bujqësore ku janë vendosur parcelat të cilat kanë krijuar kompleks të parcelave/tokë bujqësore të përshtatshme për qiradhënie.

Pasi që është krijuar kompleksi i pronave me kulture dhe gjendjen faktike të kulturës bujqësore gjatë shpalljes së këtyre parcelave është vërejtur se parcela nr. 715-3 me kulturë arë kl.4 është vendosur në shpallje për qiradhënie por sipërfaqja e saj prej 20 ari 40 m² nuk është e përfshirë në kalkulimin e sipërfaqeve së përgjithshme dhe si pasojë e kësaj për qira është paraqitur sipërfaqja me e vogël.

Të gjitha parcelat janë të përfshira sikurse në shpallje, po ashtu edhe në vendim të Drejtorit Ekzekutiv, në raport të vlerësimit të qiradhënies si dhe në vendim të bordit, mirëpo në kalkulimin e përgjithshëm të sipërfaqes mungon parcela 715-3 me sipërfaqe 20 ari 40m², si rrjedhojë sipërfaqe total në vend se të ishte 6ha 70ari 04m² (67004m²), është paraqitur 6ha 49ari 64m² (64964m²) siç ishte paraqitur në qiradhënien e dt.29.02.2023.

MH





Prandaj, pasi që të gjitha parcelat janë të përfshira në shpallje dhe po ashtu në të gjitha dokumentet tjera mirëpo mungon vetëm tek përfshirja në sipërfaqën e përgjithshme atëherë me anë të këtij vendimi përmirësohet gjendja/sipërfaqja rrjedhimisht edhe vendimi i Bordit Nr. Ref. BD-200/21 të datës 29.03.2024.


Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/77

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga objektet e përkohshme “Lokali Nr. 14 në Fushë Kosovë”; “Lokali nr. 16 tek ish-Proleteri në Prishtinë”; “Lokali nr. 32 tek Shkolla Normale në Prishtinë” dhe “Lokali nr. 48 i cili gjindej në Lipjan” që ishin pronë e NSh “Kosovarja” PRN001 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetë respektivisht nga shitoret 14, 16, 32 dhe 48 që ishin pronë e NSh “Kosovarja” PRN001 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Keto asete janë rast për heqje dorë për faktin se objektet e përkohshme (lokali nr. 14 në Fushë Kosovë) që është objekt i kësaj kërkesë ndodhej i vendosur në pronën e “Hotel Drenica” në atë kohë. Ndërsa, lokali nr. 16 ka qenë i vendosur tek ish –Proleteri në Prishtinë; lokali nr. 32 i cili ishte i vendosur në oborrin e shkollës normale në Prishtinë dhe lokali nr. 48 i cili gjindes në Lipjan, kanë qenë të vendosura në prona në pronësi komunale. Këto objekte të përkohshme në bazë të informatave janë rrënuar menjëherë pas lufte dhe nuk dihen shkaqet e sakta të rrënimit përpos shitores nr. 48 që ndodhej në Lipjan e cila ishte rrënuar nga ana e KK Lipjan menjëherë pas lufte. Duke qenë që këto objekte/lokalit janë në regjistrin e asetëve të NSh-së edhe përkundër mosekzistencës së tyre, Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk janë fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtyre objekteve nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, dhe për këtë arsye, ne po kërkojmë leje për të hequr dorë nga këto asete.

Në arkivin e NSh-së sipas Zyrës Rajonale Prishtinë nuk posedojmë asnjë dokument pronësor për të parë sa ka qenë sipërfaqja e objekteve apo edhe foto për të parë se si janë dukur këto objekte.


Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/78

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligji, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga lokali në sipërfaqe prej 96 m² i NSh "Mekanizimi" PRN098 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga lokali në sipërfaqe prej 96 m² i NSh "Mekanizimi" PRN098 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Keto asete janë rast për heqje dorë për faktin se lokali në sipërfaqe prej 96 m² që është objekt i kësaj kërkesë ndodhet në i ndërtuar në pronën e cila ishte në pronësi Komunale. Lokali gjindej në lagjen e njohur si "Qafa" në Prishtinë. Ky lokal është i rrënuar dhe nuk dihet shkaqet e sakta të rrënimin, por sipas informatave vërehet se lokali është rrënuar për shkak të vjetërsisë që kishte dhe ka qenë i pashfrytëzueshëm që nga koha e pasluftës. Poashtu, nuk ka dokumente të tjera pronësore përpos listës së asetëve të deklaruar nga ish-menaxhmenti i NSh-së që dëshmojnë pronësinë në këtë objekt dhe për më tepër në arkivin e NSh-së ka foto të objektit por vetëm në kohën kur ka qenë i rrënuar. Në bazë të raportit të gjendjes në terren ka qenë i vendosur në ngastër kadastrale e cila ka qenë në pronësi komunale.

Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, dhe për këtë arsye është vendosur që të heqet dorë nga ky aset.


Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Menfor Hysehi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/79

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga objekti i përkohshëm (Libraria Nr. 33) i NSh "Rilindja Tregtare Librare" PRN100 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aset i respektivisht nga objekti i përkohshëm (Libraria Nr. 33) i NSh "Rilindja Tregtare Librare" PRN100 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Keto asete janë rast për heqje dorë për faktin se objekti i përkohshëm (Libraria nr.33) ndodhet i ndërtuar në pronën e cila nuk ishte në ngastrën kadastrale prone e NSh-së, por në pronësi Komunale. Ky lokal është i rrënuar që nga viti 1999 dhe nuk dihet shkaqet e sakta të rrënimt.

Duke qenë që ky lokal është në regjistrin e asetëve të NSh-së edhe përkundër mosekzistencës së tij, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset.

Poashtu, nuk ka dokumente të tjera pronësore përpos listës së asetëve të deklaruar nga ish-menaxhmenti i NSh-së që dëshmojnë pronësinë në këtë objekt dhe për më tepër në arkivin e NSh-së nuk ka as ndonjë foto në mënyrë që të kemi si dëshmi dhe për të parë se si është dukur objekti.

Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aset i nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, dhe për këtë arsye është vendosur që të heqet dorë nga ky aset.


Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/80

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga objektet e përkohshme "Shitorja Nr. 14 në Fushë Kosovë dhe Shitorja Nr. 60 tek Sllovenia e Sportit në Prishtinë" të NSh "Gërmia" PRN093 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga objektet e përkohshme "Shitorja Nr. 14 në Fushë Kosovë dhe Shitorja Nr. 60 tek Sllovenia e Sportit në Prishtinë" të NSh "Gërmia" PRN093 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi. Këto asete janë rast për heqje dorë për faktin se shitorja nr. 14 e cila gjendet në Fushë Kosovë, në afërsi të stacionit hekurudhor dhe toka në të cilën ishte e vendosur shitorja e cila ishte e karakterit të përkohshëm ishte në pronësi komunale dhe heqja dorë nga Shitorja nr. 60 e cila ndodhej në afërsi të "Sllovenia Sportit" në Prishtinë e cila ishte e karakterit të përkohshëm dhe toka në të cilën ishte e vendosur ishte në pronësi komunale. Këto objekte të përkohshme në bazë të informatave janë rrënuar menjëherë pas luftës së fundit në Kosovë dhe nuk dihen shkaqet e saktë të rrënimit. Këto objekte/shitore janë në regjistrin e asetëve të NSh-së edhe përkundër mos ekzistencës së tyre, është për të hequr dorë nga këto asete. Po ashtu, nuk ka dokumente të tjera pronësore përpos listës së asetëve të deklaruar nga ish-menaxhmenti i NSh-së që dëshmojnë pronësinë në këtë objekte dhe për më tepër në arkivin e NSh-së nuk ka as ndonjë foto në mënyrë që të kemi si dëshmi dhe për të parë se si janë dukur këto objekte.


Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, dhe për këtë arsye është vendosur që të heqet dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseini
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/81

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti siç përshkruhet në certifikatën nr. P-71611019-00001-160 ZK Glllogjan me sipërfaqe prej 350 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti – pronë e NSh “KB Bujqësia” PEJ055.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga ngastrat kadastrale -71611019-00001-160 ZK Glllogjan me sipërfaqe prej 350 m² pronë e NSh “KB Bujqësia” PEJ055.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar se shfrytëzohet si rrugë fushore, apo saktësisht rrugë që shërben për qasje të pronarëve të tokave bujqësore përreth për në pronat e tyre. Kjo ngastër është në mesin e ngastrave tjera (apo vazhdim i tyre) që shërbejnë si rrugë fushore dhe e cila shërben për qasje në tokat tjera bujqësore banorëve apo pronarëve të tokave bujqësore në atë zonë

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë fushore, e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar. Në këtë rast, edhe pse rrugë fushore kategorizohet si rrugë publike dhe duhet pasur parasysh nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që “rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike”.

Duke qenë se është rrugë fushore, në kuptim të Ligjit për Rrugët, kjo pjesë mund të klasifikohet si Rrugë e pakategorizuar, siç parashihet në nenin 2 të këtij Ligji “Rrugë e Pakategorizuar e ka kuptimin e çdo rruge që nuk është rrugë publike, pronari i së cilës është një banor apo grup banorësh, dhe nuk është nën përgjegjësinë e Ministrisë, por e cila është jozyrtarisht e shfrytëzuar nga këmbësorët, automjetet dhe mjeteve tjera lëvizëse që lëvizin anash në hapësirën e pashënuar”.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.


Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/82

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti siç përshkruhet në certifikatën nr. P-70101013-02010-1 ZK Stubell e Epërme me sipërfaqe prej 280 m2 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti – pronë NSh “Agromorava” GJI035
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga ngastra kadastrale nr. P-70101013-02010-1 ZK Stubell e Epërme me sipërfaqe prej 280 m2 – pronë NSh “Agromorava” GJI035.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar se shfrytëzohet si rrugë fushore, apo saktësisht rrugë që shërben për qasje të pronarëve të tokave bujqësore përreth për në pronat e tyre.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë fushore e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar. Në këtë rast, edhe pse rrugë fushore kategorizohet rrugë publike dhe duhet pasur parasysh nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që “rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike”. Duke qenë se është rrugë fushore, në kuptim të Ligjit për Rrugët, kjo pjesë mund të klasifikohet si Rrugë e pakategorizuar, siç parashihet në nenin 2 të këtij Ligji “Rrugë e Pakategorizuar e ka kuptimin e çdo rruge që nuk është rrugë publike, pronari i së cilës është një banor apo grup banorësh, dhe nuk është nën përgjegjësinë e Ministrisë, por e cila është jozyrtarisht e shfrytëzuar nga këmbësorët, automjetet dhe jeteve tjera lëvizëse që lëvizin anash në hapësirën e pashënuar”.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore

M4



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.


Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/83

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset siç përshkruhet në certifikatën nr. P-71813061-00243-3 ZK Novak me sipërfaqe prej 85 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset – pronë e NSh “Vreshtaria” PRZ010.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aset i respektivisht nga ngastra kadastrale nr nr. P-71813061-00243-3 ZK Novak me sipërfaqe prej 85 m²– pronë e NSh “Vreshtaria” PRZ010.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar se shfrytëzohet si rrugë publike e paasfaltuar që lidhet me rrugë të tjera lokale.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aset nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë fushore e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar. Në këtë rast, edhe pse rrugë e paasfaltuar kategorizohet rrugë publike dhe duhet pasur parasysh nenin 6 par.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, në të cilin parashihet që “rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike”. Në kuptim të Ligjit për Rrugët, siç parashihet në nenin 2 të këtij Ligji “Rruga Lokale e ka kuptimin e rrugës publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune” dhe kësajsoj”.

Poashtu ky rast është në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët “asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike”.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/84

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Raporti përfundimtar për shitjen e $\frac{1}{2}$ e parcelës kadastrale 00271-3 me sipërfaqe 46.5 m², e cila përfshinë $\frac{1}{2}$ e objektit banesorë përdhese me sipërfaqe 46.5 m² dhe $\frac{1}{2}$ e katit të parë (P+1), me sipërfaqe 46.5 m² në vlerë prej 35,340 € me blerës
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Mënaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për shitje direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e $\frac{1}{2}$ e parcelës kadastrale 00271-3 me sipërfaqe 46.5 m², e cila përfshinë $\frac{1}{2}$ e objektit banesorë përdhese me sipërfaqe 46.5 m² dhe $\frac{1}{2}$ e katit të parë (P+1), me sipërfaqe 46.5 m² në vlerë prej 35,340,€ me blerës

Raporti Përfundimtar i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Divizioni ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Ky rast ka pasur vlerësimin, si në vijim: Raporti fillestar i Vlerësimit është dorëzuar në AKP me 05 shkurt 2024 në vlerë të përgjithshme prej €41,850 ose €900/m². AKP ka kërkuar plotësimin e raportit fillestar të vlerësimit me 15 shkurt 2024. Versioni përfundimtar i raportit të plotësuar të vlerësimit është dorëzuar në AKP me 20 shkurt 2024 me vlerën e përgjithshme prej €35,340 ose 760/m², i cili u aprovua sipas dispozitivit të këtij vendimi.


Në raportin e vlerësimit janë përfshirë informatat lidhur me pronën në fjalë të NSh-së, krahasimet me pronat tjera dhe deklarimi për zbatimin e Standardeve të Vlerësimit (SEV 2020) për përcaktimin e vlerës së drejtë të asetit në pajtim me nenin 4 dhe nenin 5 të Rregullores për shitjen direkte të asetëve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore duke mos e paragjykuar vlerën e përcaktuar në momentin kohor të vlerësimit të asetit në fjalë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.


Prishtinë, më 23 maj 2024





Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/85

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 9908/2016 në mes të "NSHBQ Drenica", Drenas/Gllogoc dhe , Nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e tokës bujqësore në fshatin Zabel i ultë dhe Poklek, Komuna e Drenasit/Gllogocit me sipërfaqe prej 2.5 hektarë, me qira vjetore prej 125.00 € për asetin e NSh "Drenica", Drenas/Gllogoc PRN011.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës së qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se pala ishte qiramarrës i tokës bujqësore në Fshatin Zabel i ultë dhe Poklek, Komuna e Drenasit/Gllogocit me sipërfaqe prej 2.5 hektarë që nga dt. 01.10.2015 e tutje përmes marrëveshjes me ish-Menaxhmentin e ndërmarrjes. Me 11.04.2024 Zyra Rajonale e Mitrovicës ka pranuar shkresën me nr. pr: 5326/2024, nga pala i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga prindi i tij në kjo për arsye se qiramarrësi ka ndërruar jetë. Gjithashtu, pala i ka bërë mbjellat bashkërisht me qiramarrësin e ndjerë


Ky aset ka qenë i përfshirë në procesin e rivlerësimit, saktësisht në grupin e tretë të rivlerësimit për të cilat Bordi ka diskutuar me datë 16 tetor 2023. Ky aset edhe pas procesit të rivlerësimit nuk ka pasur rritje të çmimit. Aseti është në listën e aseteve potenciale të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Këto parcela janë pjesë e parcelave që i nënshtrohen procesit të komasacionit të inicuar nga ana e KK Drenas. Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke marrë gjithashtu për baze se qiramarrësi aktualisht është i rregullt me pagesa, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/86

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSH-ve, nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoll 10683/2016 në mes të NSH "KB Agrokultura", Mitrovicë dhe _____ nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e tokës bujqësore në fshatin i ultë dhe Poklek, Komuna e Drenasit/Gllogocit me sipërfaqe prej 2.5 hektarë, me qira vjetore prej 125.00 € për asetin e NSH "Drenica", Drenas/Gllogoc PRN011 nga data 01 tetor 2023.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës së qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se pala _____ ishte qiramarrës i tokës bujqësore në Fshatin Frashër, Komuna e Mitrovicës me sipërfaqe prej 8 hektarë deri në momentin e vdekjes së tij. Ky aset ka hyrë në qiradhënie përmes ish-menaxhmentit të NSH-së. Më 06.09.2023 ZR Mitrovicë ka pranuar shkresën me nr. Prot: 5266/2024 nga pala _____ i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga _____ tek _____ kjo për arsye se qiramarrësi _____ me datën 28.07.2023 ka ndërruar jetë. Pasi që qiramarrësi ka ndërruar jetë, kontrata nuk është vazhduar dhe pas aprovimit të kërkesës për transferim të kontratës së qirasë, kontrata do të nënshkruhet dhe do të jetë efektive retroaktivisht nga data 01 tetor 2023.

Ky aset ka qenë i përfshirë në procesin e rivlerësimit, saktësisht në grupin e tretë të rivlerësimit për të cilat Bordi ka diskutuar me datë 16 tetor 2023. Ky aset edhe pas procesit të rivlerësimit nuk ka pasur rritje të çmimit. Aseti është në listën e aseteve potenciale të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Këto parcela janë pjesë e parcelave që i nënshtrohen procesit të komasacionit të inicuar nga ana e KK Mitrovicë e Jugut.


Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke marrë gjithashtu për baze se qiramarrësi aktualisht është i rregullt me pagesa, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë paditë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyzeni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/87

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të kërkesave, nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
- a) Nga si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 87 në sipërfaqe prej 100 m², e cila ndodhet në Tregun të Amortizatorët tek në shumën prej 300.00 Euro/muaj;
 - b) Nga si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 66 me sipërfaqe prej 50 m², e cila ndodhet në Tregun të Amortizatorët tek në shumën prej 150 Euro/muaj;
 - c) Nga si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 68 me sipërfaqe prej 45 m², e cila ndodhet në Tregun të Amortizatorët tek në shumën prej 135.00 Euro/muaj;
 - d) Nga përfaqësues i NTP Akoma të si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 193 në sipërfaqe prej 150 m² e cila ndodhet në Tregun të Amortizatorët tek i në shumën 450.00 Euro/muaj.
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartëcekur, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të pagujnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
- a) si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 87 tek Tregu të Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1,939.73 Euro;
 - b) si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 66 tek Tregu të Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 969.92 Euro;
 - c) si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 68 tek Tregu të Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 872.91 Euro;
 - d) përfaqësues i NTP Akoma të si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 193 tek Tregu të Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1,247.04 Euro.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

14/11



Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se NSh "Tregu" Prishtinë PRN104, është në proces të likuidimit që nga data 14 Korrik 2014. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit kryesisht në qiradhënie të hapësirave afariste.

Në këtë rast duhet kemi parasysh NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe të lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe kemi parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë. Poashtu, nuk është paraparë ndonjë kufizim për transferim të kontratave të qirasë, siç mund të jetë që transferimi i kontratave të qirasë të bëhet vetëm ndërmjet familjarëve ose partnerëve në një biznes, as në këto Kontrata të Qirasë, por si kusht kërkohet vetëm pëlqimi nga ana e AKP-së.

për tokën afariste me nr. 87 tek Tregu te Amortizatorët, në sipërfaqe prej 100 m2 ka borxh të papaguar në shumën prej 1,939.73 Euro. Para nënshkrimit të aneks kontratës të transferuar tek Irfan Mjeku në rast të aprovimit të kërkesës nga ana e Bordit të Drejtorëve do të kërkohet që të paguajë këtë borxh të papaguar, në të kundërtën aneks kontrata e transferuar nuk do të nënshkruhet dhe do të kërkohet që parashtruesi i kërkesës të lirojë hapësirën dhe për borxhin e papaguar do të ndërmirren veprime ligjore.

si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 66 me sipërfaqe prej 50 m2 ka borxh të papaguar në shumën prej 969.92 Euro, ndërsa për pjesën e tokës afariste me nr. 68 ka borxh të papaguar prej 872.91 Euro. Njëjtë edhe për këtë qiramarrës para nënshkrimit të aneksit të kontratës së qirasë të transferuar do të kërkohet që të shlyejë të gjithë borxhin.

si përfaqësues i NTP Aqoma te qiramarrësi i pjesës së tokës afariste me nr. 193 tek Tregu te Amortizatorët në sipërfaqe prej 150 m2 ka borxh të papaguar në shumën prej 1,247.04 Euro. Para nënshkrimit të aneks kontratës së transferuar të qirasë tek nga qiramarrësi aktual do të kërkohet të paguhet pjesa e borxhit të papaguar.

Kontratat tek personat tek të cilët do të transferohen nuk do të dorëzohen deri sa të paguajnë borxhin e papaguar, dhe poashtu do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore në rast se ky borxh nuk paguhet dhe do të kërkohet edhe lirimi i pjesëve të tokave afariste specifike.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/88

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, neneve 10.1.2 dhe 10.1.3 i Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist "22 Dhjetori" në Rr. Kolashini pn, Mitrovicë veriore, me sipërfaqe totale prej 149.98 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 250.00€ bruto në muaj për Komunën Mitrovica veriore për pronën e NSh Lux.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se NSh Lux Mitrovicë – MIT039 është në proces të likuidimit që nga data 19 Gusht 2013. Lokali afarist "22 Dhjetori" i cili ndodhet në Rr. Kolashini në Mitrovicë veriore është pjesë e ndërtesës afariste-banesore. Sipas kontratës së shitblerjes nr. 1081 të datës 10 tetor 1977 ndërmjet ndërmarrjes BVI dhe NSh Lux lokali afarist ka sipërfaqe prej 149.98 m² dhe aktualisht është listuar apo kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes. Me datë 19.03.2024 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokollit 04-463/02-0003200124, të parashtruar nga Komuna Mitrovicë veriore, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokali afarist, për nevoja të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Komuna Mitrovicë veriore konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, me të njëjtën kërkesë të datës 18.03. 2024 Komuna e Mitrovicës Veriore ka deklaruar se ka mundësi të paguaj shumën prej 250.00 € në muaj (bruto). AL ka deklaruar se çmimi i propozuar nga ana e KK Mitrovicë e Veriut është i pranueshëm, duke konsideruar faktin se aktualisht nuk ka të interesuar për qiradhënie të këtij lokali afarist.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/89

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Neni 8 dhe 9 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti nr. P-71208072-02694-4 ZK Mitrovicë me sipërfaqe prej 32 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti pronë e NSh "IMB Industria e Miellit dhe e Bukës" MIT001.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga ngastra kadastrale nr. P-71208072-02694-4 ZK Mitrovicë me sipërfaqe prej 32 m²– pronë e NSh IMB Industria e Miellit dhe e Bukës MIT001. Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë është e evidentuar si pjesë e pandarë e parcelës 02694-0 e cila është në pronësi të KK Mitrovicë e Jugut dhe nuk është e qartë që kjo sipërfaqe e vogël prej 32 m² në cilën pjesë të parcelës 02694-0 ndodhet për arsye se mungon ndarja grafike e kësaj parcele dhe poashtu si pjesë e parcelës 02694-0 vërehet qartë që është breg i lumit Ibër.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe mund të klasifikohet si pasuri ujore artificiale, përveç kësaj në pajtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës pasuri ujore artificiale përfshin "resurset ujore të cilat janë krijuar si rezultat i zhvendosjes apo rregullimit të rrjedhave natyrore ujore". Për më tepër, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Ujërat të Kosovës "Me qëllim të mbrojtjes së ujërave, shfrytëzimit të përgjithshëm të ujit, pasurive tjera ujore të cilat kryhen për nevoja të interesit publik, pronarit ose poseduesit të tokës dhe të resurseve ujore, mund t'i kufizohet shfrytëzimi i tyre, në pajtim me ligjin".

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/90

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga pjesa ideale $\frac{1}{2}$ e aseteve nr. P-73808130-00012-1 me sipërfaqe prej 238 m²; P-73808130-00012-4 me sipërfaqe prej 86 m² dhe P-73808130-00012-5 me sipërfaqe prej 102 m² ZK Mitrovicë e Veriut dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti pronë e NSh Urbanizmi.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht nga pjesa ideale $\frac{1}{2}$ e aseteve nr. P-73808130-00012-1 me sipërfaqe prej 238 m²; P-73808130-00012-4 me sipërfaqe prej 86 m² dhe P-73808130-00012-5 me sipërfaqe prej 102 m² kadastrale nr. P-71208072-02694-4 ZK Mitrovicë me sipërfaqe prej 32 m²— pronë e NSh Urbanizmi.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se këto parcela janë të evidentuara në certifikatën e pronësisë me shfrytëzim si tokë ndërtimore dhe tokë tjetër jo-pjellore, në të cilën që nga vitet e gjashtëdhjeta (60-ta) janë ndërtuar objekte banimi kolektiv, do të thotë banesa në të cilat jetojnë disa familje. Parcelat ndodhen në Rr. Çeta e Minatorëve p.n. Kati përdhese i objektit banesor i është ndarë ish punëtorit të Entit për Sigurim Social dhe për këtë ekziston edhe dëshmitë që Enti i ka ndarë banesën dhe kati i parë i objektit banesor i është ndarë ish punëtorit të NSh Urbanizmi. Agjencia nuk ka informata për ekzistimin e ndonjë vendimi për lejen e ndërtimit apo dhënien në shfrytëzim të këtyre banesave, por kemi deklaratën e ish-drejtorit të NSh-së me nr. protokollit 1418/2015 të datës 11.02.2015 ku deklaroi që NSh Urbanizmi nuk i ka pasur në posedim këto prona dhe as nuk i ka pasur të regjistruara në regjistrin e pronave të mbetura sepse parcelat në fjalë ishin dedikuar për ndërtimin e objekteve të banimit për ish punëtorët e Entit Social.

AL arriti në përfundim se në këtë parcelë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana Agjencisë, për shkak se në tërë këto parcela janë ndërtuar objekte banesore për banim kolektiv disa dekada para luftës së fundit në Kosovë. Për më tepër, Agjencia nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "Urbanizmi" është pronare e objektit. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, dhe për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset.



AL arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe nuk mund të bëhet bartja e pronësisë së parcelave në fjalë në emër të personave privat, për arsye se ndërtesa është e destinuar për banim kolektiv nga ana e banorëve që jetojnë në atë zonë dhe nuk posedojmë ndonjë dëshmi që ndonjë personi i është dhënë me vendim e drejta mbi shfrytëzimin e përhershëm të tokës ndërtimore apo ka të drejtën e pronësisë në ndërtesën e ndërtuar në tokën ndërtimore, në të cilën ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm, sipas ndonjë pune tjetër juridike siç është dhënia në shfrytëzim të përhershëm e tokës ndërtimore, me kompensim apo pa kompensim, për ndërtimin e ndërtesave, pjesë tjetër e parcelave është rrugë dhe hapësira publike që janë në shfrytëzim për interes publik dhe të njëjtat janë në bashkëpronësi me Komunën.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/91

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-70806008-00523-1 ZK Vrellë me sipërfaqe prej 840 m2 ZK Vrellë, Istog dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet pronë e NSh Teuta Vrellë PEJ136.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par.2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht nga ngastra kadastrale P-70806008-00523-1 ZK Vrellë me sipërfaqe prej 840 m2 ZK Vrellë, Istog - pronë e NSh Teuta Vrellë PEJ136. Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se kjo parcelë shfrytëzohet si lapidar i dëshmorëve shqiptar të rënë në luftën e fundit në Kosovë, i cili ndodhet në qendër të fshatit Vrellë. AL arriti në përfundim se aset nuk është fitimprurës dhe nuk mund të bëhet bartja e pronësisë së parcelave në fjalë në emër të personave privat.

Për më tepër, heqja dorë nga këto aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/92

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga lokali i rrënuar i NSh "Barnatoret e Prishtinës" PRN068 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**
- I. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht nga lokali i rrënuar i NSh "Barnatoret e Prishtinës" PRN068.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se lokali është i rrënuar, nuk ka mbetje të tij dhe ndodhet në parcelën nr. 00583-1 ZK Graçanicë dhe kjo parcelë është pronë e KK Graçanicë. Nuk dihen shkaqet e saktë por koha e rrënimit të këtij lokali mendohet të jetë menjëherë pas luftës së fundit në Kosovë dhe duke qenë që ky lokal është në regjistrin e asetëve të NSh-së. Në bazë të raportit të gjendjes në terren tanimë në këtë parcelë në pronësi të KK Graçanicë është i ndërtuar objekti i Kuvendit Komunal të Graçanicës kësajsojë Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të për të hequr dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së asetëve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/93

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 par. 2 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-73808130-00011-2 me sipërfaqe prej 160 m²; P-73808130-00012-2 me sipërfaqe prej 302 m² dhe P-73808130-00012-3 me sipërfaqe prej 17 m² të cilat ndodhen në ZK Mitrovicë e Veriut dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet pronë e NSh Ndërtimtari PRN033.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht nga ngastrat asetet nr. P-73808130-00011-2 me sipërfaqe prej 160 m²; P-73808130-00012-2 me sipërfaqe prej 302 m² dhe P-73808130-00012-3 me sipërfaqe prej 17 m² të cilat ndodhen në ZK Mitrovicë e Veriut - pronë e NSh Ndërtimtari PRN033.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra 00011-2 në certifikatën e pronësisë paraqitet me shfrytëzim si rrugë e pakategorizuar; ngastra 00012-2 paraqitet me shfrytëzim si tokë bujqësore – Kullosat dhe nggastar 00012-3 paraqitet me shfrytëzim si Tokë Ndërtimore – Oborr, në të cilat ngastra që nga vitet e shtatëdhjeta (70-ta) janë të ndërtuara objekte banimi kolektiv, në të cilat jetojnë disa familje dhe poashtu një pjesë e vogël e këtyre parcelave shfrytëzohet si trotuar.

AL arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Agjencisë, për shkak se në njërin parcelë është ndërtuar një ndërtesë e cila shfrytëzohet për më shumë se gjashtëdhjetë vite nga ana e banorëve që jetojnë aty, në njërin parcelë kemi vendim për dhënie në shfrytëzim të përhershëm për një person privat që nga viti 1965 ku Kuvendi Komunal i asaj kohe i ka dhënë për shfrytëzim të përhershëm kësaj pale. Duke qenë se një pjesë është rrugë publike e parcelës 00012-2 dhe në një pjesë shtëpia e banimit e cila është ndërtuar që nga viti 1965 në bazë të vendimit për shfrytëzim të përhershëm vendimin 01-4407 të datës 07.05.1965, dhe për këto arsye pasi që pronësia të kalojë në Kuvendin Komunal, duhet të jetë Kuvendi Komunal përgjegjës që të bëjë azhurnimet kadastrale dhe të bëjë matjet dhe përcaktotë pjesën që i takon palës private në bazë të vendimit të cilin vet Kuvendi Komunal i asaj kohe e ka nxjerrë. Ndërsa, parcela 00012-3 në bazë të raportit të vizitës në terren shfrytëzohet si trotuar nga ana e banorëve përreth.



Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, dhe për këtë arsye, ne po kërkojmë leje për të hequr dorë nga këto asete.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/94

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga lokali i rrënuar i NSh "Blinaja" PRN087 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga lokali i rrënuar i NSh "Blinaja" PRN087. Lokali nr. 13 që është objekt i këtij vendimi ndodhet në parcelën nr. 01968-3 ZK Lipjan, dhe kjo parcelë është pronë e KK Lipjan.


Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se lokali është i rrënuar i tëri dhe në bazë të raportit të gjendjes në terren tanimë në këtë parcelë në pronësi të KK Lipjan është ndërtuar rrugë dhe hapësira të parkingut dhe kështu AL arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe gjithashtu për shkak të mos ekzistencës tanimë të këtij lokali nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv. Duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, dhe për këtë arsye është vendosur për të hequr dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/95

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71813068-06982-2 me sipërfaqe prej 816 m² dhe P-71813068-07054-2 me sipërfaqe prej 790 m² ZK Prizren dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet - pronë e NSh Remont Servis Prizren PRZ031.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete të kalojnë pjesërisht në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale nr. P-71813068-06982-2 me sipërfaqe prej 816 m² dhe P-71813068-07054-2 me sipërfaqe prej 790 m² ZK Prizren - pronë e NSh Remont Servis Prizren PRZ031.

Këto asete janë rast për heqje dorë për faktin se ngastrat kadastrale që janë objekt i kësaj kërkesë shfrytëzohen në pjesën më të madhe të tyre si rrugë dhe në një pjesë të vogël ka ndërhyrje ka një objekt për banim kolektiv. Kjo rrugë është rrugë publike e asfaltuar me 4 korsi në Prizren, investim i KK Prizren.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk janë fitimprurës sa i përket pjesës që shfrytëzohen si rrugë dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike".

Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të për të hequr dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/96

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-70917048-01106-0 ZK Kaçanik me sipërfaqe prej 470 m2 dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet – pronë e NSh NTSH Sharr GJ1105.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhen paluajtshmëritë në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale nr. P-70917048-01106-0 ZK Kaçanik me sipërfaqe prej 470 m2 pronë e NSh NTSH Sharr GJ1105.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastrat kadastrale nr. P-70917048-01106-0 ZK Kaçanik me sipërfaqe prej 470 m2 që është objekt i kësaj kërkesë sipas gjendjes faktike është evidentuar si lapidar, saktësisht është i ndërtuar lapidari i dëshmorëve të asaj zone.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetit nuk është fitimprurës dhe duke qenë në këtë gjendje është e pamundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset.

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/97

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet P-71611071-01135-0 me sipërfaqe prej 65 m²; P-71611071-00996-0 me sipërfaqe prej 65 m² dhe P-71611071-00997-1 sipërfaqe prej 12 m² ZK Pejë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti – pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale P-71611071-01135-0 me sipërfaqe prej 65 m²; P-71611071-00996-0 me sipërfaqe prej 65 m² dhe P-71611071-00997-1 sipërfaqe prej 12 m² ZK Pejë - pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.

Këto asete janë rast për heqje dorë për faktin se ngastrat që janë objekt i këtij vendimi në certifikatën e pronësisë nuk ka ndonjë evidencë për llojin e shfrytëzimit, mirëpo në bazë të raportit të vizitës në terren në këto parcela janë të ndërtuara objektet banesore që nga vitet e gjashtëdhjeta (60-ta) janë ndërtuar objekte banimi kolektiv, do të thotë banesa në të cilat jetojnë disa familje.


AL arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Agjencisë, për shkak se në tërë këto parcela janë ndërtuar objekte banesore për banim kolektiv në vitet e 70-ta. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "17 Nëntori" është pronare e objektit. Aaseti nuk është fitimprurës dhe duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-203/98

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m²; P-71611071-00245-2 me sipërfaqe prej 360 m²; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m²; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m²; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m² dhe P-71611071-00568-0 232 m² ZK Pejë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet - pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale -71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m²; P-71611071-00245-2 me sipërfaqe prej 360 m²; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m²; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m²; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m² dhe P-71611071-00568-0 232 m² ZK Pejë pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.

Këto asetet janë rast për heqje dorë për faktin se ngastrat që janë objekt i këtij vendimi në certifikatën e pronësisë nuk ka ndonjë evidencë për llojin e shfrytëzimit, mirëpo në bazë të raportit të vizitës në terren në këto parcela janë të ndërtuara objektet banesore që nga vitet e gjashtëdhjeta (60-ta), pra janë ndërtuar objekte banimi kolektiv dhe poashtu një pjesë e këtyre parcelave shfrytëzohet si rrugë dhe trotuar.


AL arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Agjencisë, për shkak se në tërë këto parcela janë ndërtuar objekte banesore për banim kolektiv në vitet e 70-ta. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "17 Nëntori" është pronare e objektit. Aseti nuk është fitimprurës dhe duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asetet nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024.




Mentor Hysehi
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-203/99

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi propozimi i Menaxhmentit të AKP-së për pronën e NSh Metaliku që:
 - i) Kërkesa e Alfa Minerals për pagesën e qirave të papaguara në vlerë prej 10,872.48€ në këste, të aprovohet pjesërisht ku pagesa duhet të bëhet në 6 (gjashtë) këste, ku pjesa e borxhit që duhet të paguhet për muaj është në vlerë prej 1,812.08 € duke filluar me pagesën e parë nga muaji maj 2024 deri në tetor 2024, kjo për shkak të realizimit sa më të shpejtë të qirave të papaguara. Pagesa e kështit duhet të bëhet së bashku me pagesën e qirasë mujore, dhe në rast të vonesës automatikisht do të shkëputet kontratat dhe lënda do të dërgohet në përmbarrim.
 - ii) Kërkesa e Mac Solutions për pagesën e qirave të papaguara në vlerë prej 48,743.53 € të aprovohet pjesërisht ku pagesa duhet të bëhet në 6 këste meqë kontrata e qirasë ka skaduar me datë 31 janar 2024, dhe e njëjta është subjekt i vazhdimit për periudhën 1 vjeçare, ku pjesa e borxhit që duhet të paguhet për periudhën maj-tetor 2024 është në vlerë prej EUR 8,123.92 për çdo muaj, kjo për shkak të realizimit më të shpejtë të qirave të papaguara. Pagesa e kështit duhet të bëhet së bashku me pagesën e qirasë mujore, dhe në rast të vonesës automatikisht do të shkëputet kontratat dhe lënda do të dërgohet në përmbarrim
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për shqyrtimi e kërkesës së qiramarrësve Alfa Minerals & Alloys dhe Mac Solutions për pagesë të obligimeve të qirasë me këste për pronën e NSh Metaliku.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin pas vendimit të Bordit të datës 30.01. 2024 qiramarrësi Alfa Minerals është njoftuar që Bordi ka vendosur që shumica e borxheve të qirasë të paguhet nga secili qiramarrës pa përjashtim si dhe mos respektimi i kontratave të qirasë do të pasojë me shkëputje të kontratave nga Bordi. Po ashtu është njoftuar se nëse nuk i përmbush obligimet e qirave të papaguara, nga ana e AKP-së do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore lidhur me realizimin e pagesës së vlerës së qirasë së papaguar si dhe do të ndermirren veprime për lirim të pronës dhe që do të faturohet për pagesë të qirasë deri në momentin e liritimit të pronës. Me datë 05.02.2024 është dërguar shkresë tek qiramarrësi Alfa Minerals përmes së cilës i është kërkuar që brenda 5 (pesë) ditëve nga pranimi i shkresës të i përmbush të gjitha obligimet lidhur me pagesën e borxhit të qirasë, që dalin nga kontratat e qirasë për 5 (pesë) asete të NSh Metaliku, i cili borxh është në shumë prej EUR 10,872.48, dhe pas kalimit të këtij afati në rast që nuk i përmbush obligimet, ti largoj të gjitha gjësendet nga objektet dhe ti dorëzojnë çelësat e objektit.

Qiramarrësi Alfa Minerals me datë 22.02.2024, është përgjigjur në kërkesën e AKP-së për kryerjen e obligimeve kontraktuese të dërguar me datë 5 shkurt 2024, përmes së cilës ka deklaruar se borxhi në vlerë prej 10,872.48 € nuk derivon nga të gjitha kontratat e qirasë, por ky obligim është vetëm për kontratën e qirasë/depo e lëndës së parë. Në këtë përgjigje qiramarrësi Alfa Minerals ka njoftuar që duke pasur parasysh që objektin subjekt i kontratës, depon e lëndës së parë e ka pranuar nga muaji prill 2022, pasi janë larguar mbetjet kimike, dhe ka kërkuar që obligimi i akumuluar të ndahet në dy pjesë, ku ky qiramarrës merr përsipër të paguajë 50% (5,436.24 €) të borxhit kurse pjesa tjetër ti zbritet. Me datë 27.02.2024, qiramarrësit Alfa Minerals iu është dërguar



përgjigje përmes së cilës është njoftuar që AKP-ja qëndron prapa kërkesës të datës 5 shkurt 2024 për pagesën e tërë shumës së borxhit të akumuluar si dhe vendimit të Bordit të dt.30.01.2024, ku është vendosur që të paguhet e gjithë shuma e borxhit të qirasë (në vlerë prej 10,872.48 €) dhe mos respektimi i kontratave të qirasë do të pasojë me shkëputje të kontratës së qirasë nga Bordi. Me datë 04.03.2024, AKP-ja ka pranuar kërkesën/përgjigjen nga qiramarrësi Alfa Minerals, përmes së cilës ka njoftuar që pajtohet ta paguan borxhin e akumuluar dhe atë me këste mujore ashtu siç e sheh të arsyeshme AKP-ja. Po ashtu ka theksuar se meqenëse është një investitor dhe palë serioze në projektet e saj dhe për faktin se është në fazën e investimeve ka kërkuar që obligimi të mundësohet që borxhin ta paguaj me këste, ashtu që e gjithë shuma e borxhit të paguhet brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve.

Gjithashtu pas vendimit të Bordit të datës 30.01.2024 qiramarrësi Mac Solutions është njoftuar që Bordi i Drejtorëve ka vendosur që shuma e borxheve të qirasë duhet të paguhet nga secili qiramarrës pa përjashtim si dhe mos respektimi i kontratave të qirasë do të pasojë me shkëputje të kontratave nga Bordi, si dhe është njoftuar se nëse nuk i përmbush obligimet e qirave të papaguara, nga ana e AKP-së do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore lidhur me realizimin e pagesës së vlerës së qirasë së papaguar si dhe do të ndërmerren veprime për lirim të pronës dhe që do të faturohet për pagesë të qirasë deri në momentin e lirimit të pronës. Me datë 05.02.2024 është dërguar shkresë tek qiramarrësi Mac Solutions përmes së cilës i është kërkuar që brenda 5 (pesë) ditëve nga pranimi i shkresës të i përmbush të gjitha obligimet lidhur me pagesën e borxhit të qirasë, që dalin nga kontratat e qirasë për 5 (pesë) asete të Ndërmarrjes Metaliku, i cili borxh ishte në shumë prej 34,065.67€, dhe pas kalimit të këtij afati në rast që nuk i përmbush obligimet, duhet ta lirojë pronën, ti largojë të gjitha gjësendet nga ngastra kadastrale nr. 116-1 ZK Gjakovë jashtë qytetit. Qiramarrësi Mac Solutions me datë 23.02.2024 është përgjigjur në kërkesën e AKP-së për kryerjen e obligimeve kontraktuese të datës 05.02.2024 dhe ka deklaruar se nga muaji shtator 2023 ka filluar me pagesën e qirasë, sipas tij atëherë kur ka filluar ta shfrytëzoj pronën dmth atëherë kur është larguar rimorkio nga prona. Në këtë përgjigje qiramarrësi Mac Solutions ka theksuar se meqenëse pronën/parcelën nr. 116-1 e ka pranuar nga muaji shtator 2023 ka kërkuar që borxhi i akumuluar të ndahet në dy pjesë, dhe merr përsipër që të paguajë 50% (17,032.84€) e borxhit kurse pjesa tjetër kërkon që ti zbritet. Me datë 27.02.2024, qiramarrësit Mac Solutions iu është dërguar përgjigje në kërkesë përmes së cilës është njoftuar që AKP-ja qëndron prapa kërkesës të datës 05.02.2024 për pagesën e tërë shumës së borxhit të akumuluar si dhe vendimit të Bordit dt.30.01.2024, ku është vendosur që të paguhet e gjithë shuma e borxhit të qirasë (në vlerë prej 34,065.67 €) dhe mos respektimi i kontratave të qirasë do të pasojë me shkëputje të kontratës së qirasë nga Bordi. Me datë 04.03.2024, AKP-ja ka pranuar kërkesën/përgjigjen nga qiramarrësi Mac Solutions, përmes së cilës ka njoftuar që pajtohet të paguaj borxhin e akumuluar dhe atë me këste mujore ashtu siç e sheh të arsyeshme AKP-ja. Po ashtu ka theksuar se meqenëse është një investitor dhe palë serioze në projektet e saj dhe për faktin se është në fazën e investimeve ka kërkuar që borxhi të mundësohet që të paguhet me këste, ashtu që e tërë pagesa e borxhit të kryhet brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-203/100

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-70403007-00289-2 me sipërfaqe prej 799 m²; P-70403007-00295-0 me sipërfaqe prej 813 m² dhe P-70403007-00296-0 me sipërfaqe prej 759 m² ZK Lladovë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti – pronë e NSh KB Zhegra GJI024.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale -, P-70403007-00289-2 me sipërfaqe prej 799 m²; P-70403007-00295-0 me sipërfaqe prej 813 m² dhe P-70403007-00296-0 me sipërfaqe prej 759 m² ZK Lladovë – pronë e NSh KB Zhegra GJI024.


Këto asete janë rast për heqje dorë për faktin se ngastrat që janë objekt i këtij vendimi shfrytëzohen në tërësi si varreza. Në këto parcela janë varrezat e fshatit Lladovë dhe të tri këto parcela janë të rrethuara me gardh metalik nga banorët e këtij fshati. Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk janë në gjendje të kenë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontrolli efektiv për arsye se ky këto parcela shfrytëzohen si varrezë, e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar dhe duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në formë të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024




Mentor Hyseni

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





hNr. Ref. BD-203/101

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, nenit 10.1.5 i Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 maj 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të tokës pa oborr - baza e objektit në sipërfaqe prej 825m² (2,871€) dhe oborrit në sipërfaqe prej 454m² (794.5€) në pronësi të NSH Amortizatorët në likuidim me seli në Prishtinë, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 3,666€/muaj bruto për parashtruesin e kërkesës "Viva Fly" sh.p.k.
- II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale, Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga 04.10.2019 – 31.05.2024 për shfrytëzimin e tokës pa oborr - baza e objektit në sipërfaqe prej 825m² dhe oborrit në sipërfaqe prej 454m², përveç qirasë mujore në vlerë prej 3,666€/muaj bruto që do të paguhet nga data e nënshkrimit të kontratës me garancion bankar, qiramarrësi "Viva Fly" sh.p.k. duhet të paguajë retroaktivisht shumën totale prej 204,929.00 € bruto (3,666.00 € X 55 muaj e 27 ditë (04.10.2019 – 31.05.2024) para nënshkrimit të kontratës së qirasë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit për aprovimin e qiradhënies direkte për asetet pronësi të NSH Amortizatorët në Prishtinë - PRN047 për Viva Fly sh.p.k.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se pas analizimit të kontratës së privatizimit të kompleksit të Fabrikës së Amortizatorëve, kopjes së planit, vizitës në teren, është vërejtur se një objekt komercial shtrihet në tokën respektivisht në një pjesë të ngatës kadastrale nr. 1560/13 e cila në fakt nuk është privatizuar apo nuk i është bartur blerësit të Fabrikës së Amortizatorëve. Zyrtari i rastit ka kontaktuar me shfrytëzuesin edhe fizikisht edhe me shkrim. Me datë 9/11/2022 përfaqësuesi i Viva Fly shpk ka parashtruar kërkesë për marrjen në shfrytëzim me qira të tokës komerciale në pronësi të NSH Amortizatorët.

Prona/toka objekt i i kërkesës për qiramarrje është një pjesë e ngatës kadastrale 1560/13 ZK Prishtinë e cila gjendet te tregu me shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë. Kjo pjesë e tokës ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugë dytësore.

Sa i përket kësaj pike, Autoriteti i Likuidimit ka angazhuar kompaninë e licencuar gjeodezike për të konstatuar gjendjen e saktë faktike në teren respektivisht çka shfrytëzon dhe cilën sipërfaqe e shfrytëzon Viva Fly si dhe të bëjë matjet e kësaj sipërfaqe e cila shfrytëzohet.



Me datë 14 maj 2024, kompania ka dalë në teren dhe sipas marrëveshjes ka bërë inspektimet e nevojshme dhe matjet në teren me ç' rast raporti i matjes apo ekspertizës rezulton si në vijim:

Pas këtyre matjeve të konstatuara nga kompania gjeodezike, komisioni ka bërë ri vlerësimin e qirasë mujore duke rezultuar si në vijim:

- toka pa oborr - baza e objektit në sipërfaqe prej 825m² me cmim 2,871€ dhe
- oborri në sipërfaqe prej 454m² me cmim 794.5€

Periodha 3 vjeçare retroaktive përfshin periudhën prej dhjetor 2019 deri më dhjetor 2022, periudhë e cila i llogaritet retroaktivisht nga momenti që ka parashtruar kërkesën, pasi që kësaj konsiderohet pohim i faktit të shfrytësimit të asetit për atë periudhë. Ndërsa periudha prej 1 vit e 7 muaj e 27 ditë paraqet periudhën prej dhjetorit 2022 deri në 31 maj 2024, periudhë prej së cilës pala kishte parashtruar kërkesën dhe kërkesa ishte në shqyrtim në AKP dhe poashtu gjatë kësaj periudhe pala ka vazhduar me shfrytëzimin e asetit.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 maj 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit